

**STATUT**  
**SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**pOint engineering**

Ne kete status

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901. dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i Shoquerise;

**Kreu 1**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1:**

1. Emri i Shoquerise eshte "**pOint engineering**" (Shoqeria), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj.
2. Ortaket e Shoquerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoquerise te perfaquesuar ne kuota.
3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :
  - fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "sh.p.k.".
  - Numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
  - adresë e regjistruar dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqeria do to kryeje aktivitetin e meposhtem:

Projektim supervizim, konsulence, studim dhe zbatim ne arkitekture, strukture, hidro-sanitar, mbrojte nga zjarri, dizenjim universal, eficience energjitike.

Ky aktivitet perfshin cdo kategori dhe tipologji projektimi si: objekte turistike, banimi, industriale, gendra tregtare, social-kulturore, objekte kulti, objekte arsimore, projektim/sistemim peisazhi, siperfaqe te gjelbra, lulishte e parqe, projektim qender spitalore.

Analiza parametrike dhe performance ne fushen e eficences energjitike. ndricimit, akustikes, dizenjimit universal, dhe mbrojtjes nga zjarri.

**Neni 3:**

**Kohezgjatja**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

**Neni 4:**

**Selia**

- (1) Selia e shoquerise ndodhet ne adresen: Rruga:"Shyqyri Bërxolli",Rezidencia: "Inter-Cosat" Shkalla: A, Kati: 8, Apartamenti: 30A
- (2) Adresa e faqes se internetit te shoquerise eshte (nese ka):  
[www.pointarkitekture.com](http://www.pointarkitekture.com)
- (3) Adresa e shoquerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon (nese ka):  
[point.arkitekture@gmail.com](mailto:point.arkitekture@gmail.com)

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

(I) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1000 Leke (\**sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me i vogel se 100 leke*\*). Pjesernarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij te meposhtme:

1. Themelues Sokol Dervishi : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 1000 qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve to kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane to kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e ci la merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- g) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.



### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shogerine per ceshjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare to shoqdrisE;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- g) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertEve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shparblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "c" te kesaj pike:
- dh) mbiqeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve to ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve to asamblese;
- i) ceshjtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet to permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites a t'u dergohet to gjithe ortakeve. jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes i to ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord. per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve. qe kerkojne nje shumice te zakonshme. asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

NE rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshje, te chat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ". ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesës se kuorimit te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite. me te njejtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e per gjithshme vendllo me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesernarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendllo me shumicen e votave te ortakeve pjesernarres, per ceshjtë te tjera si

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe to eksperreve kontabel te autorizuar;
- c) percaktirnin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12**

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

I. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim to tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- c) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku. te cilin perfaqeson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

(1) Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riparteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

(2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie to kontrolluar e anasjelltas, cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

(3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Administrator I Shoqerise do te jete:

**Sokol Dervishi.** I biri I Hysen dhe Hysnie Dervishi, lindur me 21.04.1981 ne Bulqise, dhe banues ne Rruga “Albanipoli”, Pallati Nr 57 Apt 43, Tirane, me kombesi Shqiptare, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr I10421066J, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, to vendllo nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- g) per gatisin dhe nenshkrnjn bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpemdarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;

- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencdn e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare to Rregjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pwrgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve to posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mhulqene detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, to cilat kand nje vlere me to lane se 5 per qind te aseteve te shoqerise. qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve to para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te lane se 5 per qind te aseteve te shoqerise, cie rezulton ne pasqyrat e fundit financiare td certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme mund to shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit. ne baze te marredhenieve kontraktore me shogerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen. per te perballuar ne menyre individuate ose solidarisht sipas rastet pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme td detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 to ligjt "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- I. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire to shocierise ne teresi. duke i kushtuar vetnendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arrijen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

g) to parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojsphem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre to arsyeshme me qEllimet e shoqerise tregtare, me perjashtim to rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 td ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me to kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullit e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator. ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, par pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjt "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" kryen veprimet e me poshtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;

9) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare. kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet:

d) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte to ngrine padi penale kunder administratorit

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plate te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshe. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkeses se padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

**Kreu IV****Viti finanziar - ekspertet****Neni 16****Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 17****Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejttes vendimore qe ka.

**Kreu V****Prishja —riorganizimi i shoqerise****Neni 18****Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave to falimentimit;
- c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piker' 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuiditnit ne gjendjen e aftesise paguese, me Perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve. brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19****Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligji 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."



## Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## Neni 21

### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### *ORTAKET*

### *E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR*

**\* pOint engineering\***

*Sokol Dervishi*

